



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 12 të Rregullores MF - NR – 04/2017, dt. 13.06.2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, si dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. l 10–391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike të projekteve të organizatave jo- qeveritare në fushën e shërbimeve sociale, që kontribuojnë në krijimin e një rrjete mbrojtëse sociale për grupet e marginalizuara, të diskriminuara e madje edhe të rrezikuara si në vijim

- Fëmijët / pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktimat e krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – riintegrimi dhe fuqizimi
- Prindërit vet ushqyese në gjendje të nevojës sociale
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social në viset rurale dhe urbane;
- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Te miturit në martesat e hershme vajzave dhe djemve – parandalimi dhe vetëdijesimi
- Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore – nevoja logopedike,
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Veteranet dhe invalidët e luftës.

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi

kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve, do të ofrohet nga buxheti i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 75526.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 400,000.OO€ (katërqind mijë euro).

1. Mjetet e përmendura në nenin 1. do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi, përfshinë:

1. Tekstin e thirrjes publike;
2. Udhëzimet për aplikantë;
3. Formularët e aplikimit;
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;

1

5. Forma për raportimin e zbatimit të projektit;

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni, janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta;
4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit;

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare

<https://prishtinaonline.com/drejtore/mireqenia-sociale/subvencionet>

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantë, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një komision vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve, si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar, që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për



financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.
2. Komuna e Prishtinës do t'i njoftojë përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Mirëqenies Sociale e Komunës së Prishtinës.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Zyrës për marrëdhënie me publikun,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

A handwritten signature in blue ink is written over a blue circular official stamp. The stamp contains the text "KOMUNA E PRISHTINES" and "KRYETARI" around the perimeter, with "OSOVA" at the bottom. The signature is a stylized, cursive script.